



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PRESDENNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	16.02.2026
01 NR/BR.	41/26
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës.
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi 
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 51 pika 2.6, neni 59 pika 3 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM- VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013

Neni 1

Qëllimi i këtij propozim-vendimi është riorganizimi i brendshëm i administratës komunale, rritja e efikasitetit institucional dhe avancimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët në përputhje me kompetencat ligjore të Komunës.

Neni 2

Me këtë propozim ndryshohet neni 59 pika 1 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, ashtu që propozohet riorganizimi dhe themelimi i drejtorive komunale sipas renditjes e përshkrimit si në vijim:

1. Drejtoria e Administratës dhe Digjitalizimit;
2. Drejtoria e Financave;
3. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit;
4. Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Kapitale;
5. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit;
6. Drejtoria e Arsimit;
7. Drejtoria e Kulturës;
8. Drejtoria e Rinisë dhe Sportit;
9. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
10. Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë,
11. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
12. Drejtoria e Shërbimeve Publike;
13. Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave;
14. Drejtoria e Inspeksionit.

Neni 3

Themelimi i këtyre drejtorive është i domosdoshëm për ushtrimin më efektiv të kompetencave komunale, forcimin e administratës lokale dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 4

4.1 Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës.

4.2 Ky propozim i ndryshimit dhe plotësimit të Statutit i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas procedurave dhe shumicës së paraparë me ligj.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës me vendimin nr. 61, të datës 31.03.2022, ka marr vendim për vënien në diskutim publik të ndryshimit dhe të plotësimit të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr. 01 Nr. 50 të datës 28.06.20213, përkatësisht të nenit 59 pika e 1 të Statutit.

Brenda afateve ligjore me datë 11.05.2022, në sallën e Kuvendit të Komunës është mbajtur debati publik për plotësim ndryshimin e Statutit, në këtë debat publik nuk ka pasur qytetarë të interesuar për të marr pjesë.

Andaj bazuar në këtë që u tha më lartë i propozoj Kuvendit të Komunës që të aprovoj këtë propozim vendim ashtu siç është përshkruar në nenin 2.

Të bashkangjitur gjeni:

- *Vendimin e Kuvendit të Komunës me Nr. 01 Nr.61, të datës 31.03.2022;*
- *Procesverbalin nga konsultimi publik për plotësim ndryshimin e Statuti të Komunës neni 59 pika 1;*
- *Raporti i ecurisë së konsultimit publik për Statutit e Komunës së Ferizajt.*

REPUBLICA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Gatëse: Izlazne Data: Brana 02.10.2022

Nr. Grgj Dio jed 01	Nr. Prot Br. Prot 61	Nr. Faqev Br. Strana 7
------------------------	-------------------------	---------------------------

Ferizaj - Uroševac



REPUBLICA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.61
Data: 31.03.2022

Në bazë të dispozitave të nenit 12, pika 12.3 neni 40, pika 40.2 shkronja a), neni 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 11, neni 51, pika 2.6, 2.8 dhe 2.9 neni 59 pika 3 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2022 mori këtë:

VENDIM

PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË
STATUTIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT 01.NR.50 TË DATËS 28.06.2013.
PËRKATËSISHT NENIT 59, PIKA 1 TË KËTIJ STATUTI.

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt me numër 01.Nr.91/22 i datës 21.03.2022, për vënien në diskutim publik të ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013.

II

Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet neni 59, pika 1 ashtu që riorganizohen dhe shtohen drejtoritë komunale si vijon:

- 1.1.Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
- 1.2.Drejtoria e Financave;
- 1.3.Drejtoria e Urbanizimit dhe Mjedisit;
- 1.4.Drejtoria e Infrastrukturës;
- 1.5.Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmi;
- 1.6.Drejtoria e Arsimit;
- 1.7.Drejtoria e Kulturës;
- 1.8.Drejtoria e Rinisë dhe Sportit;
- 1.9.Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- 1.10.Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë;
- 1.11.Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë;
- 1.12.Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- 1.13.Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
- 1.14.Drejtoria e Inspeksionit.

III
Pas miratimit të këtij plotësim ndryshimi të Statutit, bëhet përfshirja e plotësimeve dhe ndryshimeve në Statutin bazë të Komunës së Ferizajt, përfshirë edhe aspektin teknik, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës.

IV
Interpretimin autentik të këtij Statuti e bënë Kuvendi i Komunës.

V
Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

VI
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga konsultimi publik për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Ferizajt

Me datën 11.05.2022 në sallën e Kuvendit të Komunës së Ferizajt është mbajtur konsultimi publik për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Ferizajt.

Në këtë konsultim publik ka marrë pjesë nënkryetari i Komunës së Ferizajt Lulzim Aliu, Liridon Jetishi përgjegjës për konsultime publike, Shyhrete Topalli, udhëheqësja e zyrës për informim si dhe mediat lokale.

Në këtë konsultim publik nuk ka pasur qytetarë të interesuar për të marrë pjesë. Me këtë rast para mediave nënkryetari Aliu, ka thënë se duhet të ndryshohet edhe forma e konsultimeve publike për shkak se qytetarët nuk janë shumë të interesuar që të marrin pjesë në hartimin e këtyre dokumenteve.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Pas këtij konsultimi publik nënkryetari Aliu, ka mbajtur takime me grupe të ndryshme të interesit.

Ky konsultim publik ka përfunduar në orën 10:15.

Procesmbajtës

Liridon Jetishi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Raport i ecurisë së konsultimit publik për Statutin e Komunës së Ferizajt

Qershor 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Hyrje

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar edhe në nenin 9 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e takimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt).

Me datën 26.02.2022, konform afateve ligjore janë publikuar njoftimit në uebfaqen zyrtare të komunës, në platformën e konsultimeve publike.

Në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/takime-publike/>



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41383>

Poashtu konsultimi publik është transmetuar edhe në mediat lokale në këtë link:

<https://ëëë.facebook.com/share/v/1CEëëëGn45/>

-Me 19.05.2022, është publikuar procesverbali për mbajtjen e takimit publik, i publikuar në këtë vegëz: <https://ferizaj.rks-gov.net/procesverbal-nga-konsultimi-publik-per-plotesim-ndryshimin-e-statutit-te-komunes-se-ferizajt/>

Njoftimi ka qenë publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike si dhe në rrjetin social facebook.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Të pranishëm në konsultim kanë qenë: Në këtë konsultim publik ka marrë pjesë nënkryetari i Komunës së Ferizajt Lulzim Aliu, Liridon Jetishi përgjegjës për konsultime publike, Shyhrete Topalli, udhëheqësja e zyrës për informim si dhe mediat lokale.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuara
1-Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë konsultimit publik për Statutin e Komunës së Ferizajt	11.05.2022 10:00-10:15	F M T 2 4 6	Nuk ka pasur	

Shtojca-Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuara dhe të refuzuara.

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për konsultimit publik për	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
----	---------------------------------	---	---



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

	Statutin e Komunës së Ferizajt	
--	-----------------------------------	--

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Raporti është përgatitur nga:

Liridon Jetishi: 